

PËRBALLJA ME PANDEMINË COVID-19

Mbi të gjitha, pandemia COVID-19 është krizë globale shëndetësore. Në të njëjtën kohë, ndikimi i saj në ekonominë globale po rritet në mënyrë eksponenciale, me implikime afatshkurtra dhe afatgjata në biznes. **Bizneset duhet të përballen me këtë krizë në mënyrën e duhur.** Secili nivel i një strukture të korporatës e ka rolin e vet në përgjigjen dhe të siguruarit se zbatohen praktikatat më të mira. Kemi renditur këtu disa çështje për t'u marrë parasysh që mund të jenë të dobishme për ju si udhëheqës të kompanisë. Përgjithësisht të zbatueshme për çdo lloj biznesi; disa këshilla mund të mos jenë relevante bazuar në natyrën ose madhësinë e biznesit tuaj, strukturën e aksionarëve ose faktorë të tjerë. Merrni këto në konsiderim sipas zbatueshmërisë.

ZOTIMI NDAJ ÇËSHTJEVE MJEDISORE, SOCIALE DHE TË QEVERISJES



Demonstroni leadership dhe mbani një kulturë të mirë korporative

- A po demonstroni leadership: komunikim i qartë dhe në kohën e duhur me punonjësit tuaj dhe palët tuaja kryesore? Në mënyrë specifike: Shëndeti dhe siguria e punonjësve janë të rëndësishme më të madhe dhe ju duhet ta trajtoni ndikimin e COVID-19 në *punonjësit* dhe *biznesin* tuaj.
- A është komunikuar qartë angazhimi juaj për t'iu përmbajtur udhëzimeve lokale të shëndetit publik për parandalimin e përhapjes së virusit?
- A e keni kontrolluar/rishikuar Planin tuaj të Vazhdimësisë së Biznesit (PVB) dhe a e keni azhurnuar, nëse është e nevojshme, për të përcaktuar nëse në të merret parasysh situata aktuale? Nëse jo, shqyrtojeni mundësinë që menjëherë ta azhurnoni PVB-në tuaj.
- A e keni angazhuar funksionin e pajtueshmërisë për ta monitoruar pajtueshmërinë me politikat dhe procedurat e PVB-së? Sigurohuni që ata të dinë t'i përshkallëzojnë problemet në kohë reale, me qasje të drejtpërdrejta te Bordi.

BORDI I DREJTORËVE



Mbikëqyrni menaxhimin e krizës

- A po mbani takime urgjente ose *ad hoc* të Bordit? Përdorni këto takime për ta vendosur tonin “në krye” të kompanisë lidhur me urgjencën e krizës dhe për të dërguar porosinë e udhëheqjes dhe mbikëqyrjes së fortë.
- A është mbledhur një Komitet ad hoc i COVID-19 ose i Krizave apo komiteti i menaxhimit të rrezikut i ngarkuar me mbikëqyrjen e ndikimeve të krizës? A e keni marrë në konsiderim anëtarësimin në një komitet të tillë - përfshirë menaxhmentin e lartë, burimet njerëzore, operacionet, teknologjinë e informacionit (TI)?
- A jeni duke bërë diskutim të hapur për atë nëse Bordi ka aftësi dhe shkathtësi për ta mbikëqyrur PVB-në dhe udhëheqjen e kompanisë përgjatë krizës? Nëse përgjigja është jo, rritni ekspertizën e Bordit me mbështetje të jashtme në planin afatshkurtër dhe rishqyrtoni përbërjen e Bordit në planin afatgjatë.
- A ka ndërmarrja një plan të vazhdimësisë pas emergjencës dhe a është ai gati të aktivizohet? Planifikoni që të ketë persona kyç rezervë në dispozicion për organizatën.

“Kur godet një krizë, qeverisja e mirë korporative mund t’i mundësojë kompanisë të planifikojë në mënyrë efektive reagimin e vet, të shpërndajë rolet dhe përgjegjësitë e përcaktuara qartë dhe ta vendosë një strategji efektive të komunikimit. Veprimet e tilla u ndihmojnë kompanive të rimëkëmben shpejt dhe ta minimizojnë dëmin në biznesin e tyre.” - Orientimi përmes krizës: Një manual për bordet

MENAXHMENTI

- A keni krijuar një Ekip të Menaxhimit të Krizave për ta hartuar një plan gjithëpërfshirës për t’i trajtuar ndikimet e krizës nën skenarët/situatat e ndryshme të mundshme? Plani duhet të jetë i lidhur me intensitetin dhe kohëzgjatjen e krizës dhe efektet e mundshme në likuiditet, financim, linjat kryesore të biznesit dhe zinxhirët e furnizimit.
- A keni vendosur që të bëhen telefonata/takime virtuale periodike dhe të përsëritura ndërmjet Ekipit të Menaxhimit të Krizave dhe Komitetit të Krizave të Bordit?
- Si raportohen te Bordi ndikimet në fuqinë punëtore?
- A keni përcaktuar se kush është thelbësor gjatë kësaj krize dhe cilat aftësi kritike ‘të krizës’ mund të jenë të nevojshme, duke formuar potencialisht ekupe që punojnë nga vende të ndryshme?
- A keni nevojë të krijoni një Ekip të Menaxhimit të Likuiditetit? Konsideroni përfshirjen e likuiditetit brenda fushëveprimit të Ekipit të Menaxhimit të Krizave.

MJEDISI I KONTROLLIT

(SISTEMI I KONTROLLIT TË BRENDSHËM, FUNKSIONI I AUDITIMIT TË BRENDSHËM, QEVERISJA E RREZIKUT DHE PAJTUESHMËRIA)



Siguroni që të jeni të përgatitur dhe t’i përgjigjeni krizës fuqishëm

A funksionojnë mirë funksionet kryesore të Kontrollit? Shqyrtoni:

- **Kontrollet e brendshme:** sa janë adekuate politikat dhe procedurat e PVB, kontrollet e TI-së në lidhje me punën nga largësia, siguria e vendit të punës, siguria e ushqimit, etj. Mos harroni problemet kibernetike/të teknologjisë informative. Në kohë krize, këto dobësi mund të përkeqësohen.
- **Pajtueshmëria:** sa është adekuate pajtueshmëria me kontrollet përkatëse, duke përfshirë por pa u kufizuar në PVB, TI, sigurinë, etj.
- **Auditimi i brendshëm:** kapaciteti i procedurave alternative për vazhdimin e planit të punës së auditimit dhe raportimin, vlerësimi i përshtatshmërisë së PVB-së, këshillimi për mangësitë e kontrolleve përkatëse dhe veprimet korrigjuese.
- **Menaxhimi i rrezikut:** vlerësimet e rrezikut dhe masat për uljen e rrezikut për rreziqet e menjëhershme përkatëse, si dhe ndikimet afatgjata.

Nëse ato nuk janë testuar kohët e fundit ose nuk jeni të sigurt se a janë testuar, kryeni këtë testim. Nëse janë testuar kohët e fundit, vazhdoni ta monitoroni zbatimin e tyre me raportime të rregullta dhe korrigjime.

SHPALOSJA DHE TRANSPARENCA



Ndërtoni besimin përmes komunikimit

- A po mbani komunikime të menjëhershme dhe të rregullta me investitorët dhe të gjitha grupet e rëndësishme të interesit për mënyrën se si COVID-19 është duke ndikuar në biznes? Palët e interesit përfshijnë punonjësit, klientët, furnizuesit, komunitetin lokal dhe qeverinë lokale.
- A po i komunikoni masat dhe praktikatat e lidhura me COVID-19 në uebfaqen tuaj në rast se baza e aksionarëve dhe palëve të interesit është e larmishme/ndryshme?
- A keni marrë parasysh që të ketë kërkesa për t’i shpalosur ndryshimet materiale që mund të ndikojnë në fitimet dhe perspektivat e ardhshme?
- A ka zhvilluar dhe shpallur menaxhmenti një fushatë të brendshme të komunikimit duke kërkuar nga punonjësit/stafi që të qëndrojnë në shtëpi nëse janë të sëmurë, apo të mos vijnë në punë derisa të kalojnë një kohë e caktuar?

Mos harroni: Një vazhdimësi e komunikimit të vazhdueshëm dhe të qenit të hapur me investitorët dhe palët e interesit mund ta krijojë besimin e mirë të tyre.

TË DREJTAT E AKSIONARËVE



Mbani lidhjet me investitorët në mungesë të takimeve të zakonshme të aksionarëve ballë për ballë

- Ndërsa disa investitorë i kundërshtojnë takimet virtuale dhe ato nuk lejohen në disa juridiksione, kriza COVID-19 paraqet një sfidë të jashtëzakonshme për ta mbajtur Mbledhjen e Përgjithshme Vjetore (MPV) me kohë.
- Pyetni nëse sekretari i korporatës ka menduar që ta mbajë MPV virtuale, duke marrë parasysh kërkesat ligjore dhe kufizimet siç janë statutet, aktet nënligjore dhe zgjidhjet teknologjike në dispozicion.

QEVERISJA E ANGAZHIMIT TË PALËVE TË INTERESIT



Përkrahni qëndrueshmërinë e kompanisë

- A jeni duke i komunikuar porosinë kryesore të palëve kryesore të interesit të kompanisë, lidhur me veprimet dhe përgjigjet e Kompanisë ndaj krizës? Në veçanti, këto palë duhet të përfshijnë punonjësit, klientët, furnizuesit, komunitetet lokale dhe zyrtarët e shëndetit publik.
- A keni aktivizuar një mekanizëm konfidencial të raportimit për t'i raportuar shqetësimet e punonjësve, furnitorëve dhe klientëve në lidhje me parandalimin e përhapjes?

Burime shtesë: Publikimi i KFN-së Orientimi përmes krizave: Doracak për bordet (2010) i përgatitur si pjesë e programit të përgjithshëm të KFN-së si përgjigje ndaj krizave, me financim nga Oesterreichische Entwicklungsbank (OeEB - Banka Austriake për Zhvillim) https://www.ifc.org/wps/wcm/connect/region_ext_content/ifc_external_corporate_site/east+asia+and+the+pacific/resources/navigating+through+crises+-+a+handbook+for+boards

© Korporata Ndërkombëtare Financiare 2020. Të gjitha të drejtat e rezervuara.

Shpërndarja: KFN inkurajon shpërndarjen e punës së saj dhe lexuesit të mund t'i rikrijojnë dhe shpërndajnë këto materiale për qëllime edukative dhe jo komerciale, me kusht që të jepet një atribut i duhur dhe të përfshihet mohimi i përgjegjësisë.

Mohimi i përgjegjësisë: Edhe pse konsiderohet si e besueshme, KFN nuk e garanton saktësinë, besueshmërinë ose plotësinë e përmbajtjes së përfshirë në këtë punim, as konkluzionet ose gjykimet e përshkruara këtu dhe nuk pranon përgjegjësi ose detyrim për ndonjë lëshim ose gabim (duke përfshirë, pa kufizim, gabimet tipografike (të shtypit) dhe gabimet teknike) të çfarëdoshëm në përmbajtje ose për mbështetjen në to. Çdo mbështetje e juaja ose ndonjë përdoruesi tjetër të këtij dokumenti në këto informata është rreptësisht në rrezikun tuaj.

Mësoni më shumë për KFN-në dhe punën që ne e bëjmë për t'i përmirësuar praktikën e MSQ-së: ifc.org/sustainability

Të gjitha të drejtat e rezervuara. 2121 Pennsylvania Avenue, N.W.

Uashington D.C., 20433 SHBA

Internet: www.ifc.org

Në partneritet me:



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Confederation

Federal Department of Economic Affairs,
Education and Research EAER
State Secretariat for Economic Affairs SECO



IFC

International
Finance Corporation
WORLD BANK GROUP

Creating Markets, Creating Opportunities